VENDIM
Nr. 73, datë 27.5.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "REKA ENERGY" SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "ZAJE", ME FUQI 220 kw; "TURAJ", ME FUQI 320 kw; "XHAFERAJ-MESHTEKEN", ME FUQI 3680 kw; "NOVOSEJ", ME FUQI 220 kw DHE "KOLLOVOZ", ME FUQI 1500 kw (ME FUQI TOTALE 5940 kw)

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a" dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a" e "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Reka Energy sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për licencimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Reka Energy" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.3; 4.1.4, germat "a", "b" dhe "c"; 4.1.5, germat "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Bilancin financiar; vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe dokumentet që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, germat "a", "b" dhe "c");
- Të dhënat teknike për secilin HEC; të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin dhe miratimi i pikës së lidhjes (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4, germa "d" dhe 4.1.5, germa "a"), do të njoftohet subjekti, që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë "Reka Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Zaje", me fuqi 220 kw; "Turaj", me fuqi 320 kw; "Xhaferaj-Meshteken", me fuqi 3680 kw; "Novosej", me fuqi 220 kw; "Kollovoz", me fuqi 1500 kw (me fuqi totale 5940 kw).
2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti